

**SHOQËRIA "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A**  
**ADRESA: RR. "MUHAMET GJOLLESHA", TIRANË**  
**NUIS J61807025P**

**VENDIM**  
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**  
**TË SHOQËRISË "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A.**

Sot, më datë 28.12.2020, në orën 10:00 në Tiranë, Shqipëri, pranë selisë së Shoqërisë "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A., në adresën: "Muhamet Gjollësja", Tiranë (këtej e tutje "**Shoqëria**"), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

**Janë të pranishëm**

1. **Znj. Ajola Arben Xoxa**, dtl. 16/07/1983, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I35716050T, që zotëron që zotëron 2410 aksione të Shoqërisë, apo 340,167% të kapitalit aksionar, dhe që njëkohësisht ushtron detyrën e administratores së Shoqërisë;
2. **Znj. Valbona Xhemil Xoxa**, dtl. 09/10/1958, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal F86008097P, që zotëron 2314 aksione të Shoqërisë, apo 38,567 % të kapitalit aksionar, dhe që vepron në cilësinë e Kryetares së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

E pranishme është edhe **Znj. Xhoi Skënderasi**, dtl. 08.09.1992, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T që caktohet për të vepruar në cilësinë e Sekretarit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Kryetarja e Asamblesë, Znj. V. Xoxa, deklaron se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur rregullisht, konform ligjit dhe Statutit të Shoqërisë, pa patur ndonjë kundërshtim nga secili prej aksionerëve në lidhje me këtë, për të diskutuar e vendosur mbi Rendin e Ditës së mëposhtëm.

**Rendi i Ditës**

1. **Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë;**
2. **Rizgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;**
3. **Rivlerësimi i pronave të Shoqërisë;**
4. **Miratimi i Bilancit të Vitit 2019;**
5. **Miratim i raportit të ekspertit për vlerësimin e pronave të Shoqërisë;**
6. **Të ndryshme.**

*Pasi konstaton praninë e të gjithë aksionerëve të sipërpërmendur.*

**Deklaron**

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë si të mbledhur rregullisht dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

**I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**



Kryetarja e mbledhjes merr fjakën dhe sqaron se Shoqëria disponon disa prona të paluajtshme të cilat nuk janë rivlerësuar asnjëherë dhe si pasojë, janë ende të regjistruara me një çmim tepër të ulët. Kryetarja sqaron se, në kushte normale, rivlerësimi i pasurisë së shoqërive bëhet me një vlerë tatimi të barabartë me 15%, ndërkohë që aktualisht, një ligj i posaçëm në fuqi (Ligji Nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar) e lejon Shoqërinë të kryejë rivlerësimin e pronave të saj duke paguar vetëm 5%.

Përveç kësaj, Kryetarja rikujton se nuk ka kryer asnjë rritje kapitali që prej themelimit të saj në vitin 1996. Si pasojë, me qëllim kryesisht rivlerësimin e pronave të paluajtshme të Shoqërisë, proces i cili nevojit investimin e një shume të madhe parash, por jo vetëm, edhe me qëllim rregullimin e disa pjesëve të dëmtuara strukturore të godinës ku Shoqëria kryen aktivitetin e saj, Kryetarja propozon zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë përmes emetimit të 16'000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) mijë aksioneve të reja, me vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra në total vlera e të gjitha aksioneve që do të emetohen është e barabartë me 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetë milion Lekë).

Aktualisht, Shoqëria disponon 6'000 (gjashtë mijë) aksione, me një vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra me një vlerë totale të barabartë me 6'000'000'000 (gjashtë milion lekë).

Në lidhje me Rendin e Ditës, Kryetarja i hedh në diskutim dhe në vijim të deklarimeve të sipërlistuar, pas një diskutimi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

## VENDOS

1. Emetimin e 16'000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) mijë aksioneve të reja, me vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra në total vlera e të gjitha aksioneve që do të emetohen është e barabartë me 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetë milion Lekë); me qëllim rritjen e kapitalit të Shoqërisë;
2. Cdo aksionari të Shoqërisë i lind e drejta të nënshkruajë një numër aksionesh të emetuara proporcionalisht me numrin e aksioneve që ai disponon dhe pra përqindjen në kapitalin e Shoqërisë, me qëllim ruajtjen e të njejtës përqindje në kapitalin e Shoqërisë, si pasojë e të drejtës së parablerjes;
3. Cdo aksionar ka 21 ditë kohë për të nënshkruar aksionet e emetuara që i takojnë, që nga publikimi i këtij vendimi dhe pra që nga data e regjistrimit të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Licensimit;
4. Në përfundim të këtij afati, e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja të emetuara i kalon aksionarëve të tjerë, në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji dhe Statuti i Shoqërisë;
5. Qendra Kombëtare e Licensimit do të regjistrojë fillimisht aksionet e emetuara, dhe në përfundim të afateve ligjore, do të regjistrojë edhe aksionarët që do të kenë nënshkruar aksionet përkatësisht, si edhe rritjen përfundimtare të kapitalit.

## II. RI/ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

Kryetarja e mbledhjes merr fjakën dhe informon të pranishmit se njëri prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, Z. Valter Gjoni, ka humbur rishtazi jetën. Kryetarja kërkon 1 minut heshtje në nderim të Z. Gjoni, i cili ka shërbyer në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë për shumë vite.

Në vijim Kryetarja propozon këto tri emra për të marrë mandatin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë në vijim:



- a. **Greta Domi**, e dtl. 18.05.1984, e identifikuar me letërnjoftim me nr. personal I45518082P, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- b. **Xhoi Skënderasi**, e dtl 08.09.1992, e identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- c. **Erald Simixhiu**, i dtl. 14.09.1971, lindur në Tiranë dhe banues në Austri, i identifikuar me Pasaportë Austriake me nr. P4954441, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Emrat pranohen nga Asambleja e Përgjithshme pa asnjë diskutim dhe si pasojë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

#### VENDOS

##### 6. Emërimin si anëtarë të Këshillit të Administrimit personat si më poshtë:

- a. **Greta Domi**, e dtl. 18.05.1984, e identifikuar me letërnjoftim me nr. personal I45518082P, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- b. **Xhoi Skënderasi**, e dtl 08.09.1992, e identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- c. **Erald Simixhiu**, i dtl. 14.09.1971, lindur në Tiranë dhe banues në Austri, i identifikuar me Pasaportë Austriake me nr. P4954441, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

##### 7. Tri anëtarët e Këshillit të Administrimit kanë një mandat prej 3 vitesh. Ata mund të rizgjidhen në këtë pozicion pa kufizim dhe mund të revokohen nga kjo Asamble në çdo kohë.

### III. MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË SHOQËRISË

Kryetarja rikujton të pranishmit se Inxhinieri Xhuljeta Gjini Baxhaku, me profesion inxhinieri ndërtimi, e pajisuar me Liçensë VPP. 0404/1 për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shkalla e parë, në fushën “Ndërtesa dhe Tokë Truall”, me NIPT J61828056L, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, Rr: Astrit Balluku, hyrja nr. 5, zyra nr. 6, zk. 8250, është mandatuar për të kryer rivlerësimin e pronave të paluajtshme të Shoqërisë dhe ka dorëzuar Raportin e Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme të Shoqërisë, i cili i është vënë në dispozicion aksionarëve.




Kryetarja pyet të pranishmit nëse ka ndonjë kundërshti në lidhje me këtë raport, dhe duke qenë se nuk ka asnjë kundërshti, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

#### VENDOS

##### 8. Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme të Shoqërisë, kryer nga inxhinieri Xhuljeta Gjini Baxhaku.

### IV. RIVLERËSIMI I PRONAVE TË SHOQËRISË

Kryetarja konstaton se Raporti i Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme të Shoqërisë ka konstatuar se pronat kanë një vlerë të ndryshme nga ajo e regjistruar e tyre dhe si pasojë sygejron që Shoqëria të kryejë rivlerësimin e pronave të paluajtshme të saj dhe regjistrimin e vlerave të reja pranë ASHK dhe/apo Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe institucioneve të tjera përkatëse.

   3

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr. 91/2020 dhe ligjin nr. 164/2020, përcaktohet rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për *Personat Juridikë*, të cilët kanë të drejtë të kryejnë rivlerësimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme brenda muajit dhjetor 2021. Rivlerësimi me vlerën e tregut kryhet nga vlerësues të pasurive dhe ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për rivlerësimin e pasurisë.

Në zbatim të këtij ligji, shoqëria "Botimet Enciklopedike" SH.A., me kryerjen e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme do të paguajë 5% të diferencës ndërmjet *vlerës së rivlerësimit* dhe *vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare të vitit 2019*. Pra, në rastin konkret shoqëria "Botimet Enciklopedike" për efekt dhe zbatim të këtij ligji do të tatohet në masën 5% për rivlerësimin, në ndryshim nga legjislacioni i mëparshëm tatimor që do ti takonte tatimi në masën 15% të fitimit kapital të realizuar. Theksojmë se, për të evituar tatimin në masën 15%, shoqëria "Botimet Enciklopedike" e sheh të arsyeshme të kryejë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme brenda vitit 2021, duke paguar tatimin në masën 5%.

Përfaqësuesi i shoqërisë duhet që të paraqesë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, dokumentet e mëposhtme:

1. Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurisë sipas shtojcës nr. 2, të Udhëzimit nr. 2727, datë 4.2.2020.
2. Prokurën për përfaqësuesin ligjor që do të kryejë veprimet e nevojshme.
3. Kopje të Liçencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurive.
4. Kopje të faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurive.
5. Aktin original të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe vulosur nga vlerësuesi i pasurisë.
6. Pasqyrën financiare (bilancin kontabël), të vitit 2019.
7. Kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë në masën 5% të diferencës ndërmjet rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare.

Kryetarja e hedh për diskutim këtë pikë dhe duke qenë se të gjithë të pranishmit janë dakord, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

#### VENDOS

9. Kryerjen në vijim të regjistrimit të vlerave të rivlerësuara të pronave të paluajtshme që Shoqëria disponon, pranë ASHK dhe/apo Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe institucioneve të tjera përkatëse, brenda vitit 2021;
10. Kryerjen e të gjitha pagesave të nevojshme për përmbushjen e pikës 9 më sipër dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

#### V. MIRATIMI I BILANCIT TË VITIT 2019

Kryetarja informon të pranishmit se Administratorja e Shoqërisë ka dorëzuar Bilancin/Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2019, hartuar nga financierja e Shoqërisë, Znj. Adela Kondakciu dhe ia paraqet ato Asamblesë.

Të pranishmit nuk kanë asnjë kundërshti në lidhje me Pasqyrat Financiare të Dorëzuara dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

#### VENDOS



11. Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2019 dhe mandaton Administratoren ose një person tjetër të autorizuar prej saj që të kryejë depozitimin e pasqyrave Financiare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo institucioneve të tjera, sikurse mund të kërkohet nga ligji.

## VI. Të ndryshme

Kryetarja pyet të pranishmit nëse kanë ndonjë temë tjetër për të diskutuar.

Duke qenë se të pranishmit nuk kanë tema të tjera për të diskutuar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

### VENDOS


12. Mandatimin e Administratores së Shoqërisë, Znj. Ajola Xoxa, ose një personi tjetër të autorizuar prej saj me shkrim, që të kryejë regjistrimin e këtij vendimi të Asamblesë së Përgjithshme pranë Qendrës Kombëtare të Licensimit, sikurse edhe cdo institucioni tjetër ku mund të jetë e nevojshme; gjithashtu edhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme apo të dobishme me qëllim zbatimin e të gjitha vendimeve të marra në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush tjetër nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:30.

Znj. Valbona Xoxa

*Valbona Xoxa*

Kryetare e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë



Znj. Xhoi Skënderasi

*Xhoi Skënderasi*

Sekretar i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Znj. Ajola Xoxa

*Ajola Xoxa*

Aksionare/Administratore

*Ajola Xoxa*